



Qershor 2022

Forumi i Ujit të Danubit 2022: Hidhini një sy agjendës!



28 – 29 Qershor 2022, Tiranë, Shqipëri: Pas dy vitesh shumë të gjata takimesh virtuale, familja Danube Water do të mbledhet sërish bashkë. Tema është e nxehtë, grupi i folësve është mbresëlënës, regjistrimi është i hapur dhe agjenda tashmë është e disponueshme.

Më në fund, të gjithë do të mbledhemi përsëri: Të gjithë që kanë një interes apo janë të përfshirë në sektorin e ujit të rajonit të Danubit janë të ftuar përzhemërsisht të marrin pjesë në Forumin e Ujit të Danubit 2022, organizuar nga IAWD dhe Banka Botërore në kuadër të Programit të Ujit të Danubit dhe në bashkëpunim me SHUKALB.

Për shumë vite, Programi i Ujit të Danubit ka krijuar një rrjet ndërkombëtar të institucioneve dhe ekspertëve të sektorit të ujit, të përkushtuar ndaj ndërtimit të kapaciteteve, ndarjes së

Trajnimet dhe programet e ardhshme të zhvillimit të kapaciteteve

[Tubacionet Kryesore dhe Rezervuarët e Ujit](#)
16 Qershor 2022, Tirana

[Sistemet e Vogla të Furnizimit me Ujë](#)
17 Qershor 2022, Tirana

[Mirëmbajtja e Pajisjeve – Motorrat, Pompat dhe Valvulat për Profesionistët e Ujit të Ndotur dhe të Pijshëm](#)
22-23 Qershor 2022, Tirana

Konferencat e Ardhshme Ndërkombëtare

[Humbjet e ujit 2022](#)

Pragë, Republika Çeke
19-22 Qershor 2022

[Konferenca Ndërkombëtare për Planifikimin e Sigurisë](#)

njohurive, shërbimeve analitike dhe këshillimore. [lexo më shumë](#)

Lajme nga Sektori

SHUKALB mbështet Entin Rregullator të Ujit për prezantimin e Metodologjisë së re për Miratimin e Tarifave të Shërbimeve Ujësjetellës-Kanalizime në Shqipëri



Gjatë datave 6, 13, 27 maj dhe 3 qershor 2022, Enti Rregullator i Ujit (ERRU), në bashkëpunim me SHUKALB organizuan 4 seminare rajonale mbi prezantimin e Metodologjisë së re për Miratimin e Tarifave të Shërbimeve Ujësjetellës-Kanalizime. Seminaret u organizuan me mbështetjen financiare të Bankës Botërore përmes Programit të Ujit të Danubit.

Seminaret e organizuara në Tiranë, Korçë dhe Lezhë u drejtuan nga Ndriçim Shani, Kryetar i ERRU dhe Elda Kruja, Përgjegjës i Sektorit Ekonomik dhe Tarifave, ERRU, ndërsa në seminarin e fundit të organizuar në Vlorë më 6 qershor 2022, panelit iu bashkuan edhe Ana Ismailaja, Specialist i Analizës Ekonomiko-Financiare dhe Nevila Saliu, Specialist i Analizës së Aseteve dhe Investimeve, nga ERRU.

Pjesëmarrësit në seminare të Tiranë, Korçë dhe Lezhë u përshëndetën nga Drejtoresha Ekzekutive e SHUKALB, znj. Elisabeta Poçi. [lexo më shumë](#)

[së Ujit 2022](#)

Narvik, Norvegji
22 - 24 Qershor 2022

[Konferenca e 3-të e IWA për dezinfektimin dhe nën-produktet e dezinfektimit](#)

Milano, Itali
27 Qershor - 1 Korrik 2022

[Konferenca e 14-të Ndërkombëtare mbi Hidroinformatikën](#)

Bukuresht, Rumani
4 - 8 Korrik 2022

Bashkohuni me Ne!



Na tregoni se cfarë mendoni!



Rregullatorët e Ujit të Ballkanit Perëndimor nënshkruajnë Memorandumin e Bashkëpunimit



Më 18 maj 2022, në Tiranë, katër Rregullatorë Ekonomikë të sektorit të ujit në Ballkanin Perëndimor që përfshin Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Kosovën dhe Malin e Zi, nënshkruan memorandumin e parë të bashkëpunimit si kornizë për zhvillimin e bashkëpunimit afatgjatë dhe shkëmbimin e përbashkët të praktikave, informacioneve, analizat e përbashkëta dhe krahasimet e modeleve ekzistuese rregullatore të sektorit të ujit dhe performancave të shoqërive ujësjellës kanalizime. Ky memorandum ofron themelin për një program bashkëpunimi rajonal të mbështetur nga WAREG, Shoqata Evropiane e Rregullatorëve të Ujit.

Ceremonia u organizua dhe u prit nga Enti Rregullator i Ujit (ERRU) dhe në të morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve, Shoqata Evropiane e Rregullatorëve të Ujit, SHUKALB etj. SHUKALB u përfaqësua në ceremoni nga Drejtoresha Ekzekutive Znj. Elisabeta Poçi. [lexo më shumë](#)

Rreth SHUKALB

Shoqata Ujësjellës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale, jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon të përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri.

Çfarë ka të re në SHUKALB!

SHUKALB ofron Programin D-LeaP “Plani i Sigurisë së Ujit dhe Menaxhimi i Krizave” për tre Shoqëri UK të tjera



SHUKALB ka nisur të ofrojë Programin D-LeaP “Plani i Sigurisë së Ujit dhe Menaxhimi i Krizave” (PSU&MK) për Shoqëritë UK Durrës, Shkodër dhe Fier. Ky aktivitet është një vazhdim i raundit fillestar të programit, si pjesë e të cilit pesë Shoqëri (Lushnje, Gramsh, Patos, Berat-Kuçovë dhe Belsh) u trajnuan dhe u mundësuan të zhvillonin planet e tyre për Sigurinë e Ujit dhe Menaxhimin e Krizave. Aktiviteti po mbështetet nga IAWD dhe RCDN.

Gjatë muajit maj 2022, SHUKALB organizoi dy sesione trajnimi në shoqëritë UK Durrës, Fier dhe Shkodër. Ekipi i SHUKALB-it përbëhej nga trajnerja kryesore Migena Kukli, bashkëtrajneri Elton Hasanaj; Drejtoresha Ekzekutive Elisabeta Poçi dhe Franceska Troka, Koordinatore e Programit. [lexo më shumë](#)

Ekipi i Menaxhimit të Aseteve të SHUKALB merr pjesë në Konferencën e 9-të të IWA-së për Menaxhimin Strategjik të Aseteve (LESAM)



Konferenca e 9-të e IWA-së për Menaxhimin Strategjik të Aseteve (LESAM) u organizua më 11-12-13 maj 2022, në Bordeaux, Francë. Shoqëritë UK, konsulentë, rregullatorë, studiues dhe menaxherë të asetëve u takuan për të diskutuar

SHUKALB u përfaqësua në konferencë nga dy anëtarët e ekipit të Projektit të Menaxhimit të Integruar të Aseteve: Arbana Kola, Menaxhere Projekti dhe Elton Hasanaj Inxhinier i Sistemit EDAMS. [lexo më shumë](#)

Nxitoni të regjistroheshi në kurset e ardhshme të trajnimit!



TRAJNIMET NË QERSHOR

Gjatë këtij kursi trajnimi, pjesëmarrësit do të njihen me llojet e tubacioneve më të përdorshme, si dhe karakteristikat e tyre. Pjesëmarrësit do të mësojnë hapat e nevojshme për instalimin e tubacioneve dhe do të njihen me lloje të ndryshme të

rezervuareve si dhe me procedurat e operimit dhe mirëmbajtjes së tyre.

Kursi i trajnimit është veçanërisht i vlefshëm për drejtorët e departamentit teknik dhe të shpërndarjes, kryeinxhinierët, dhe inxhinierët e mirëmbajtjes dhe të shfrytëzimit dhe inxhinieret e prodhimit. [lexo më shumë](#)

Të tjera

Zhvillohet në Shqipëri moduli i Trajnimit për Menaxhimin e Shoqërive Ujësjiellës Kanalizime “Menaxhimi i Energjisë dhe Efienca e Energjisë”



Trajnimi për Menaxhimin e Shoqërive Ujësjiellës Kanalizime (UMT) është fjala më e fundit në përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve të Partneritetit të Danubit: Një kurrikulë dyvjeçare që u ofron profesionistëve në mes të karrierës një pamje tërësore të të gjitha aspekteve të menaxhimit të shoqërive UK të orientuara drejt së ardhmes. Klasa e vitit 2021 u mbledh javën e kaluar për t'u njohur më shumë mbi operimin e shoqërive UK me efienca energjetike.

Duke u mbështetur në programet e provuara të D-LeaP dhe duke bashkëpunuar me shoqëritë kryesore në Evropën Qendrore dhe Lindore, Trajnimi për Menaxhimin e shoqërive UK synon të pajisë menaxherët aktualë dhe të ardhshëm të sektorit të ujit me mjete dhe teknika për të mbështetur vendimmarrjen e tyre. Tetë module trajnimi gjatë dy viteve mbulojnë proceset dhe funksionet kryesore në një shoqërie UK. Kursi i parë i këtij programi filloi në vitin 2021 dhe nga data 16 maj deri më 20 maj, moduli i tij i trajnimit për Menaxhimin e Energjisë dhe Efienca të Energjisë, i pesti nga tetë, u zhvillua në Tiranë dhe Korçë, Shqipëri. [lexo më shumë](#)

[Anëtarësohuni në SHUKALB](#)

[Kurset e Trajnimit](#)

[Na kontaktoni](#)

Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë,

Rruga "Pjeter Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqiperi

Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782

E-mail: info@shukalb.al, **Web:** www.shukalb.al

Çregjistrohu